

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna Drenasit
Municipality Drenas
Zyra Kryetarit



12 Nr. 400/101 - 435/17 dt. 29-07-2019

Nga: Kryetari i Komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovci

Për: Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal



LËNDA: Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt : 26.07.2019

1. Vendim për ridestitim dhe transfer të mjeteve nga kategoria e projektëve kapitale dhe kategoria për mallra dhe shërbime në shpënzime kapitale.
2. Vendim për ridestitim të mjeteve nga Drejtorati për infrastrukturë Publike.
3. Vendim për formimin e Panelit përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit për Barazi Gjinore.
4. Vendim për formimin e komisionit për plotsim/ndryshimin e Rregullorës për subvencione të Komunës së Drenasit.
5. Vendim për Financimin e Projektit Handikos- Drenas.
6. Vendim për Themelimin e komisionit Komunal të Aksioneve për NPL Stacioni i Autobusve Sh.A – Glllogoc.




Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 502/21-4351/dt. 29/07/2019

Nga: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës- z.Labinot Halli

Për: Kryetarin e Komunës z.Ramiz Lladrovci



LËNDA: Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt : 26.07.2019.

1. Vendim për ridestitim dhe transfer të mjeteve nga kategoria e projektëve kapitale dhe kategoria për mallra dhe shërbime në shpënzime kapitale.
2. Vendim për ridestitim të mjeteve nga Drejtorati për infrastrukturë Publike.
3. Vendim për formimin e Panelit përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit për Barazi Gjinore.
4. Vendim për formimin e komisionit për plotsim/ndryshimin e Rregullorës për subvencione të Komunës së Drenasit.
5. Vendim për Financimin e Projektit Handikos- Drenas.
6. Vendim për Themelimin e komisionit Komunal të Aksioneve për NPL Stacioni i Autobusve Sh.A – Glogoc.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës

12 Nr. 400-43557 dt 30. 07. 2019



Në bazë të nenit 11,12 dhe 40 pika 40.2 nën b dhe c të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të nenit 8 të ligjit për Financat e Pushtetit Lokal 03/L-049 si dhe nenit 34.6 nën b dhe c të Statutit të Komunës së Drenasit , Kuvendi i komunës në mbledhjen e vetë të mbajtur me datën 26.07.2019, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR RIDESTINIM TË MJETEVE

Neni 1.

Më këtë vendim, miratohet ridestnimi i mjeteve për shpenzime kapitale në programin buxhetor Drejtorati për Infrastrukturë Publike

Neni 2

Ridestnimi i mjeteve bëhet nga këto projekte kapitale me këto shuma :

1. Asfaltimi i rrugës në fshatin Arllat, Negroc, Gjergjicë dhe Bytyq me kod 48646 në shumë prej: 6,730.00€
2. Asfaltimi i rrugës në fshatin Baicë, Krajkovë, Damanek me kod 48640 në shumë prej: 11,998.89€
3. Asfaltimi i rrugës në fshatin Poklek i Vjetër, Poklek i Ri dhe Vasilevë me kod 48635 në shumë prej 4,130.00€
4. Asfaltimi i rrugës në fshatin Sankoc, Fushticë Epërme dhe Ulët me kod 48648 në shumë prej 7,200.00€

Shuma Totale : 30,058.89€

Neni 3.

Ridestnimi i mjeteve nga neni 1 i këtij vendimi ridestinojnë në këto projektet kapitale:

1. Asfaltimi i rrugës në Tërstenik I dhe II me kod 48633 në shumë prej: 18,728.89€
2. Ndërtimi i infrastrukturës Nekoc, Kishnarekë me kod 48641 në shumë prej 11,330.00€

Shuma Totale : 30,058.89€

Neni 4.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesën: Kryetari i Komunës ,Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Infrastrukturë Publike.

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj

Vendimi i dërgohet:

- Ministrisë së MAPL-së;
- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit;



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës
12 Nr 400-43547 dt. 30.07 2019



Duke u bazuar në nenin 11,12 dhe 40, paragrafi 2.Pika (b) dhe (c) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 34 pika 34.6 nën (c) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të mbajtur me datën 26.07. 2019, aprovoj këtë:

V E N D I M

PËR RIDESTINIM DHE TRANSFER TË MJETEVE NGA KATEGORIA E PROJEKTEVE KAPITALE DHE KATEGORIA PËR MALLRA DHE SHËRBIME NË SHPENZIME KAPITALE

Neni 1

Me këtë Vendim, miratohet ridestnimi dhe transferi i mjeteve për shpenzime kapitale në programin buxhetor të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë

Neni 2

Ridestnimi i mjeteve bëhet nga këto projekte kapitale me këto shuma:

- **Kodi i projektit I** : 10/611/18001/31270/47848/0451, Mirëmbatja edhe renovimi I pikave per kontejner 1.1 m³, në qender të qytetit **1,416.55 €**

- **Kodi i projektit II** : 10/611/18001/31120/47848/0451,Renovimi dhe Mirëmbatja e objektit të SHZSH-së në Gllobar **759.00 €**

Transferi i mjeteve nga kategoria për mallara dhe sherbime në këtë shumë:

- **Kodi i projektit III** : 10/611/18001/13460/0451, Trajtimi i qenve endacak **7,600.00 €**

Vlera totale nga këto projekte është 9,775.55 €

Neni 3

Shuma e mjeteve për Ridestnim dhe transfer të mjeteve të përmendura në nenin 2 të këtij Vendimi do të shpenzohen në këtë kategori ekonomike të shpenzimeve kapitale, konkretisht në këtë projekt

I. Shpenzimet Kapitale:


- Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjencë, ridestinimin dhe transferin e mjeteve do t'i shpenzoj në këto projekt kapitale :
- Kodi i projektit :10/611/18001/47881/0451 , Bashkfinacim projektesh...8,359.00 €,
- Kodi i projektit:10/611/31128/47879/0451 , Rregullimi i garazheve për SHZSH-në
..... 1,416.55€

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit, dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës ,Drejtoria për Buxhet e Financa dhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryetari i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj

Vendimi i dërgohet:

- Ministrisë së MAPL-së;
- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit;



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës

Nr. 12.400.43549 dt 30.07 2019



Duke u bazuar në nenin 11,12,dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 5 pika 1 nënpika 1.1 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2016 për Procedurat e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 ("Gaz. Zyrt e Republikës së Kosovës"), nenit 4, 7, 8, 9 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2016 për Procedurat e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 26.07 2019, aprovoi këtë:

V E N D I M

Për formimin e Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Barazi Gjinore

Neni 1

Më këtë Vendim Kuvendi i Komunës formon panelin përzgjedhës, i cili do të zhvillojë procedurat për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Barazi Gjinore në përbërje prej shtatë (5) anëtarëve.

1. Gentiana Morina - Anëtar nga Ekzekutivi
2. Kajtaž Kastrati - Anëtar nga Ekzekutivi
3. Florentina Kukaj - Anëtare nga Kuvendi
4. Fitore Morina - Anëtar nga Kuvendi
5. Mahije Smajli - Anëtare nga shoqëria civile

Neni 2

Kuvendi ka për obligim të themelon panelin përzgjedhës, i cili duhet të ketë në përbërje tre anëtare të kuvendit të komunës, një anëtarë nga ekzekutivi i komunës dhe një anëtarë nga shoqëria civile. Kuvendi i komunës aprovoi listën me anëtarë për komitetin konsultativ.

Neni 3


Për zgjedhjen e anëtarëve në komitetin konsultativ kuvendi i komunës shpall konkurs publik dhe përcakton kriteret për konkurrim.

Neni 4

Mandati i komitetit konsultativ pas përzgjedhjes është 4 vjeçar, nga themelimi i komitetit.

Neni 5

Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

 Kryetari i Kuvendit të Komunës
Labinot Halilaj

Vendimi i dërgohet:

- Ministrisë së MAPL-së;
- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit;



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës
Nr. 12-400.4356 dt. 30.07 2019



Duke u bazuar në nenin 11,12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040,nenit 34. pika 34.6 të Statutit të Komunës nenit 2 të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-vë, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 26.07.2019, aprovoi këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për plotësim/ndryshimin e Rregullores së Komunës së Drenasit Nr. 12-320-19338, të datës 07.04.2017, për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve

Neni 1

Kuvendi i Komunës aprovoi vendimin për formimin e komisionit për plotësim/ndryshimin e Rregullores së Komunës së Drenasit Nr. 12-320-19338, të datës 07.04.2017, për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencione, në përbërje prej pesë (5) anëtarëve, të cilin komision e përbejnë dy (2) anëtar nga Ekzekutivi i Komunës të cilët i propozon Kryetari i Komunës, dy (2) anëtar nga Kuvendi i Komunës nga subjektet e ndryshme të përfaqësuar në Kuvend, dhe një (1) anëtar nga shoqëria civile i propozuar nga Kryetari i Komunës, si vijon:

1. Agim Kastrati - anëtar nga ekzekutivi,
2. Lumturie Kiqina - anëtar nga ekzekutivi,
3. Petrit Sinani -anëtar nga kuvendi,
4. Burim Bujupi -anëtar nga kuvendi dhe
5. Gentrît Mulaku -antarë, përfaqësues nga shoqëria civile.

Neni 2

Ky komision ka për obligim harmonizimin e Rregullores Komunale Nr. 12-320-19338, të datës 07.04.2017, për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencione me Rregulloren MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Neni 3


Komisioni pas përfundimit të punës se tyre Rregulloren e ndryshuar dhe harmonizuar, i dërgon Kuvendit të Komunës për aprovim.

Neni 4

Mandati i këtij komisioni vazhdon deri në aprovimin e kësaj rregullore nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit.

Neni 5

Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Halil Halilaj

Vendimi i dërgohet:

- Ministrisë së MAPL-së;
- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit;



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës
Nr. 12. lloq. 30.07.2019



Duke u bazuar në nenin 11, 12 dhe 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34.6 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullorës 12 Nr. 320-19332, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së Subvencioneve, Rregullorës MF Nr. 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, vendimit me 12 Nr. 400-377743, të datës 03.07.2018, për Plotësim ndryshimin e Rregullorës nr. 12-320-19338 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së Subvencioneve, pastaj Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2019. Me propozim të Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve të OJQ-ve, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 26.07.2019, mori këtë :

VENDIM PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT

Neni 1

Miratohet mbështetja me mjete financiare për projektin/programin së Shoqatës të Personave me Aftësi të Kufizuara HANDIKOS-Drenas.

Neni 2

Projekti i HANDIKOS-Drenas përkrahet me shumën prej 10.000 € mjetet të cilat do të shfrytëzohen për projektin Shërbime Sociale dhe Rehabilituese të Bazuara në Bashkësi për Fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara dhe të kombinuara.

Neni 3

Mjetet financiare për realizimin e këtij projekti të lejohen nga subvencionet dhe transferet, kodi ekonomik 21/611/73010/21200/00000/0760.

Neni 4

Mjetet financiare barten në konton e Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara HANDIKOS-Drenas. DSHMS është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2 të këtij propozim vendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga e Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara HANDIKOS-Drenas që të bëjë raport tekstual dhe financiar në mënyrë që të njoftoj DSHMS për mënyren e shpenzimeve të mjeteve financiare.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset : Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Neni 6

Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labiriot Halilaj

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Kuvendit;
- OJQ- Handikos
- Arkivit;





REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 400/01-29727 dt 27/07/2019

Duke u bazuar në nenin 11,12 dhe 40,të nenit 40.2 paragrafi (e),të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040,nenit 34, të Statusit të Komunës së Drenasit (Glllogocit),si dhe nenit 5.2 të Ligjit nr.03/L-87 për Ndërmarrjet Publike,ligjit nr.04/L-111 për ndryshim plotësimin e ligjit nr.03/L-87 për Ndërmarrjet Publike. Kuvendi i komunës se Drenasit (Glllogocit) në mbledhjen e mbajtur me datë: 26.07.2019, aprovoj këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONERVE PËR NPL STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A-GLLOGOC

1. Shfuqizohet-Vendimi i Kuvendit të Komunës se Glllogocit i miratuar më datën 31.05.2019 me nr. 12/400/29727.
2. Emrohet komisioni komunal i aksionerve për NPL-SHA Stacioni i Autobusave në Glllogoc në përbërje prej:
 - 2.1. Kuvendit të Komunës dy anëtarë:
 1. Bujar Dervishi;
 2. Petrit Gashi ;
 - 2.2. Ekzekutivi i Komunës një anëtarë:
 - 1.Ruzhdi Lestrani;
3. Komisioni Komunal i Aksionerve nga pika 2 e këtij Vendimi obligohet të ushtroj të drejtat e aksonarit në përputhje me ligjin nr.03/L-087 për Ndërmarrjes Publike,Ligjin nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/L-087 për ndërmarrjet publike Nr.03/L-87 dhe ligjin nr.06/L-16 për shoqërit tregtare.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës
5. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

ARSYETIM

Bazuar në shkresën përcjellëse nr. 020-610/10 , e dt.09.07.2019, të MAPL-së, dërguar Komunës se Glllogocit, lidhur me vlerësimin Ligjësmerisë të Vendimit nr.12-400-29727, për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për NPL-SHA stacioni i Autobusëve – Glllogoc, është kërkuar harmonizimi i këtij akti juridik, me nenin 5.2 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.Ky vendim është harmonizuar me dispozitat ligjore në fuqi mbështetur në rekomandimet e MAPL-së.



Kryetari i Komunës së Drenasit

Edmond Halilaj